PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE ME DIPLOMË TË HUAJ TË SHKOLLËS SË MESME

- **Program i Integruar i studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Arkitekt**
- **Program i Integruar i studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Urbanist**

Kandidatët kandidatëve me diplomë të huaj të shkollës së mesme duhet të paraqesin pranë sekretarisë mësimore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formuarin e aplikimit sipas shtojcës nr. 2
b) Kopje të dokumentit të lëshuar nga qendra e shërbimeve arsimore që vërteton njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë qsha për njohje dhe njehsim
c) Kopjen e dokumentit të identifikimit
d) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhen shqipe). Kandidatët që kanë kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në republikën e shqipërisë
e) Dy fotografi personale
f) Kopjen e mandatpagesës
g) Deklaratën sipas shtojcës nr. 1

Shënim:

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij me prokurë.